

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. B. nga fshati M. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit K. R. nga fshati R. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale: lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1877/2013, të datës 19.03.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me datë 09.03.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit B. B. dhe mbrojtësi i tij av. A. M. nga Gjakova, si dhe të akuzuarit K. R., me datën 10.03.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **Të akuzuarit:**

**1.B. B.**, nga i ati S., e ëma S., e gjinisë Q., I lindur me..., në Gjakovë, me vendbanim në fshatin M., Komuna e Gjakovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar- shtetas i republikës së Kosovës.

**2.K. R.** nga i ati Q., e ëma A., e gjinisë Sh., i lindur me..., në Gjakovë, me vendbanim në fshatin R., Komuna e Gjakovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë - shtetas i Republikës së Kosovës.

### J A N Ë F A J T O R

#### **I akuzuari B. B.:**

**I.** Sepse me datën 30.10.2013, rreth orës 09:30 minuta, në Gjakovë në kafiterinë “M. P.” i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit I. M. nga fshati L., Komuna e Prizrenit, në atë mënyrë që i akuzuari K. R., gjersa ish-in të dera e oborrit të shkollës së mesme të mjekësisë “H. Z.” në Gjakovë, I. M. dhe F. K. i thotë I. që të shkoj në kafiterin “M. P.” dhe të bisedojnë ku aty ishte edhe B. B., i cili pa fole asnjë fjalë me dorëz të thikës e godet në kokë të dëmtuarin I. duke e rrezuar për toke pastaj me shqelma e godet në shpinë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjorë të Dr. N. H. të datës 16.01.2014.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

#### **Të akuzuarit B. B. dhe K. R.:**

**II.** Sepse me datë, vend dhe kohë të njëjtë, në bashkëkryerje i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit F. K., në atë mënyrë që i akuzuari K. R., me dorezë të thikës e godet 7

herë në kohë dhe duke u përleshur rrezohen në tokë. K. menjëherë ngritët në këmbë dhe e godet edhe dy herë në fytyrë, dhe derisa ishte i shtrirë i dëmtuari F., i pandehuri B. e godet dy herë në kokë me dorezë të thikës duke i shkakuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjekoligjore të Dr. N. H. i datës 16.01.2014.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 76 par.1 nënpar.1.7, 83, 188 par.2 dhe nenit 31 të KPRK-së, të akuzuarit i:

## **G J Y K O N**

### **1. Të akuzuarin B. B.:**

- **Për veprën penale nën.I** të dispozitivit **ME DENIM ME KUSHT** duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

- **Për veprën penale si nën.II** të dispozitivit **ME DËNIMIN ME GJOBË në shumë prej 1.000 (njëmijë) Euro**, në të cilën dënim do të llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, duke llogaritur prej datës 31.10.2013 e deri me datën 29.11.2013, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro, që i bije 600 (gjashtëqind) Euro, ndërsa pjesën tjetër të mbetur të dënimit me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) Euro, i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **2. Të akuzuarin K. R.:**

- **Për veprën penale si nën.II** të dispozitivit **ME DËNIMIN ME GJOBË në shumë prej 1.000 (njëmijë) Euro**, në të cilën dënim do të llogaritet dhe koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, duke llogaritur prej datës 12.11.2013 e deri me datën 11.12.2013, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro, që i bije 600 (gjashtëqind) Euro, ndërsa pjesën tjetër e mbetur të dënimit me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) Euro, i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, përkatësisht pjesën e mbetur të dënimit me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) Euro, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditëve, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 (njëzet) Euro.

Të dëmtuarit: I. M. nga fshati L., Komuna e Prizrenit dhe F. K. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohen të akuzuarit B. B. dhe K. R., që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidare dhe atë: për ekspertizën mjekoligjore shumë prej 50 Euro, ndërsa shpenzimet e paushallit gjyqësorë secili veç e veç shumë prej nga 30 Euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP.nr.1877/2013, të datës 19.03.2014, kundër të akuzuarit B. B. nga fshati M., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit K. R. nga fshati R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale: lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësorë Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu ka deklaruar se: meqenëse të akuzuarit kanë pranuar veprat penale për të cilat ngarkohen pa presion dhe me vullnetin e tyre të plotë ku të njëjtit i kanë kuptuar favoret dhe natyrën e pranimit të fajësisë konsideroj se gjendjet faktike si në dispozitivin e aktakuzës janë vërtetuar çka vërtetojnë se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, e kjo vërtetohet edhe nga provat që i janë bashkangjitur aktakuzës, andaj kërkojmë që gjykata të njëjtit të i shpall fajtor, të i dënoi sipas ligjit duke marr për bazë rrethanat lehtësuese e siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, gjendjen e dobët të tyre ekonomike dhe pendimin e tyre për veprat penale si dhe rrethanat rënduese nëse gjen gjykata.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit B. B. av. A. M. ka deklaruar se: pranimin e fajësisë i mbrojturi imë vullnetshëm e ka shpreh me qëllim që kjo çështje juridike penale të mbyllet. Rasti ka ndodhë me datën 30.10.2013, dhe gjerë me ditën e sodit i mbrojturi imë nuk ka kryer asnjë veprim tjetër të kundërligjshëm, prandaj këtë rrethanë gjykata duhet ta ketë parasysht gjatë matjes së dënimit, gjykata duhet të ketë parasysht edhe faktin se i mbrojturi imë ka qenë në paraburgim po ashtu edhe i akuzuari tjetër K. R., të cilën rrethanë nuk e përmendi përfaqësuesi i akuzues. Gjikata gjatë shqyrtimit dhe matjes së dënimit duhet të ketë si rrethanë edhe faktin se i mbrojturi imë gjatë konfliktit të përshkruar si në aktakuzë ka pësuar lëndime të rënda të thyerjes së dorës në bërryl, dorën e djathtë të cilat prova i ka Prokuroria dhe lidhur me këtë çështje nuk ka ndërmarrë asgjë, ne këtë çështje potencuam vetëm për faktin se i mbrojturi imë me dorë të thyer ka qëndruar 30 ditë në paraburgim. Nuk dëshirojmë që të dëmtuarit të jenë të akuzuar në këtë apo procedurë tjetër, për faktin se incidenti ka ndodhë rastësisht nuk ka pas paramendime apo paragjykime ose përgatitje të mëhershme që të ndodhë konflikti për këtë fakte ky konflikt nuk ka lënë pasojë njerëzore për faktin sipas adeteve dhe dokeve të vendit familjet e të dëmtuarit dhe të mbrojturit tim kanë arrite marrëveshje të pajtimit që në të ardhmen mos të ketë hasmëri. Andaj të gjitha këto rrethana e lus gjykatën që ti ketë parasysht së bashku me pendimin e të mbrojturit tim dhe duke marr për bazë moshën e re të tij, sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari B. B. ka deklaruar se; në tërësi pajtohem me fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim nuk ka çka të shtoj tjetër.

Në fjalën përfundimtare akuzuari K. R., ka deklaruar se unë vullnetarisht e kam pranua fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohem dhe këtë vepër e kam kryer kur kam qenë në moshë më të re dhe nuk i kam kuptuar pasojat e kësaj vepre dhe se jam penduar për këtë veprim dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë kesi lloje veprime.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këto gjendje faktike:

I. Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. B., me datën 30.10.2013, rreth orës 09:30 minuta, në Gjakovë në kafiterinë “M. P.” i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit I. M. nga fshati L., Komuna e Prizrenit, në atë mënyrë që i akuzuari K. R., gjersa ishin të dera e oborrit të

shkollës së mesme të mjekësisë “H. Z.” në Gjakovë, I. M. dhe F. K. i thotë I. që të shkoj në kafiterin “M. P.” dhe të bisedojnë ku aty ishte edhe B. B., i cili pa fole asnjë fjalë me dorëz të thikës e godet në kokë të dëmtuarin I. duke e rrezuar për toke pastaj me shqelma e godet në shpinë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjorë të Dr. N. H. të datës 16.01.2014.

II. Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit B. B. dhe K. R. në bashkëkryerje me datë, vend dhe kohë të njëjtë, i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit F. K., në atë mënyrë që i akuzuari K. me dorëzë të thikës e godet 7 herë në kokë dhe duke u përleshur rrëzohen në tokë, K. menjëherë ngritët në këmbë dhe e godet edhe dy herë në fytyrë, dhe derisa ishte i shtrirë i dëmtuari F., i akuzuari B. e godet dy herë në kokë me dorëzë të thikës duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjorë të Dr. N. H. të datës 16.01.2014.

Gjykata gjendjet e këtilla faktike i ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarve, të cilët në shqyrtimin gjyqësorë vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimit i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, e i akuzuari B. B. edhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A. M., pranimit i fajësisë mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraparë në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit B. B. në dispozitivin I të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së ndërsa në veprimet e të akuzuarve B. B. dhe K. R., të përshkruara në dispozitivin II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: për të akuzuarin B. B., gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se: është i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimit e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, do të jetë më i kujdesshëm, si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa për të akuzuarin K. R., gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, pranimit e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, do të jetë më i kujdesshëm, si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të dy të akuzuarit gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 të KPRK-së dhe qëllimi i dënimit me kushte nga neni 50 i KPRK-së sa i përket të akuzuarit B. B. dhe se këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.1 lidhur me par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.152/14, me datë 10.03.2017**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.